# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442316**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | PDK sfidon në Kushtetuese procesin e konstituimit të Kuvendit, kërkon pezullimin e hapave të mëtejshëm institucionalë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/pdk-sfidon-ne-kushtetuese-procesin-e-konstituimit-te-kuvendit-kerkon-pezullimin-e-hapave-te-metejshem-institucionale/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 08:09:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 08:05:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 08:04:00 UTC → 14 shtator 2026, 08:06:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f4e1c5f8fda38b31f0b2ca92020711cf756ccd3b5094cd735ee74220e82a7b7b` |
| TEKSTI | `af4399ec5faf2a1d2548398f41180bef2030dd80f841fb90979f12f6221f715e` |
| PAMJA | `09cd7ae4f278a0b398b2c45edf89adedc5128f5722c45df49ab39df11055494c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `89939cb9728bada0e96e1b84c74348bf0a7b73db096392b06ab4843b102f3e0e` |
| E MËPARSHMJA | `3cfc18d4e893adb43bc59b0178d5d944d3881405d4f22957ab2f14bf90991f1d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/89939cb9728bada0e96e1b84c74348bf0a7b73db096392b06ab4843b102f3e0e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# PDK sfidon në Kushtetuese procesin e konstituimit të Kuvendit, kërkon pezullimin e hapave të mëtejshëm institucionalë

14/09/2026 10:05



**Partia Demokratike e Kosovës ka kontestuar në Gjykatën Kushtetuese konstituimin e Kuvendit të Kosovës.**

Deputetët e kësaj partie, Përparim Gruda, Arian Tahiri dhe avokati Faton Fetahu, deponuan të hënën lëndën që kërkon sqarim mbi konstituimin e Kuvendit pas afatit kushtetues të përcaktuar nga vetë kjo gjykatë në qershor të vitit 2025.

"Kemi kërkuar të shpjegohet se çka do të thotë konstituimi i Kuvendit jashtë afatit kushtetues, cilat janë pasojat, çka ndodh me afatet që varen nga konstituimi, se e dini ju që rrjedh afati 60-ditor për presidentin, çka ndodh me ato afate", shprehet Përparim Gruda, deputet i PDK-së.

Partia Demokratike e Kosovës kërkon vlerësim nga Gjykata Kushtetuese edhe për konstituimin e Kuvendit pa zgjedhur një anëtar të Kryesisë, në rastin konkret, kur nuk është zgjedhur nënkryetari nga PDK-ja. Për këtë çështje, Kushtetuesja, përmes aktgjykimit të publikuar në fillim të vitit 2026, kishte sqaruar se Kuvendi nuk mund të konstituohet pa u zgjedhur kryetari dhe pesë nënkryetarët.

"Ngritëm çështjen e konstatimit jokushtetues mbi konstituimin e Kuvendit pa një anëtar të Kryesisë nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar", tha Faton Fetahu, avokat i PDK-së.

Krahas kësaj, PDK-ja ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të vendosë edhe masë të përkohshme, në mënyrë që të mos merren vendime nga një Kuvend dhe qeveri, siç thonë ata, kundërkushtetuese.

"Konsiderojmë që është imediate, shumë e rëndësishme që fillimisht të vendoset masa, në mënyrë që të mos prodhohen dëme dhe situata më të rënda në kuptim juridik, institucional, sepse edhe qeveria që është zgjedhur dje nga Kuvendi, që realisht nuk është i konstituuar, mund të vazhdojë të marrë vendime të jashtëligjshme", shprehet Arian Tahiri, deputet i PDK-së.

Partia Demokratike e Kosovës ka paralajmëruar se të martën do të kontestojë në Gjykatën Kushtetuese edhe formimin e qeverisë.

Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e re u formuan të dielën, më 13 shtator, tre muaj pas zgjedhjeve dhe jashtë afateve kushtetuese.

**Top Channel**

## Kosova dhe Rajoni »








## Kryesore



Analizë nga Filip Çakuli: Drejtësia kërkon drejtësi... për rrogën e vet!
11:35

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave
08:35

Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane
07:48

Rusia godet një tren në Ukrainë, pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarë të lartë europianë kaluan në të njëjtën linjë
07:12

Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e meritoj çmimin
07:58

## Më të lexuarat

"Dil jashtë"/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për 'Territorialen' në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debate në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Egla Cenos

Exclusive/ "Rastësia që më lidhi me Artur Zhejin", rrëfehet për herë të parë bashkëshortja e publicistit: Kam dashur vetëm ta ndjek dhe ta adhuroj

E ndoqi në hotel dhe u larguan së bashku nga klubi i natës, 17-vjeçarja gjermane shokon: Më duket se më përdhunoi një burrë 10 vite më i madh

Rama paralajmëron hapjen e 4 universiteteve të reja në vend, kryeministri zbulon qytetet që do të mirëpresin institucionet arsimore

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

"Pengu për dy fëmijët që nuk erdhën kurrë", Soni Malaj rrëqeth me rrëfimin e saj në Grida Duma Podcast

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E

pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

Ndryshon vettingu për policët, kërkohet që transferimi apo ulja në detyrë të mos ndërpresë procesin e verifikimit




Ambasada e SHBA-së paralajmëron protesta në Kosovë, udhëzim për shtetasit amerikanë në ditën e vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK

14/09 11:02



"Cilido të jetë vendimi, të respektohet"/ Deklarata e ministrit të Drejtësisë së RMV për Gjykatën Speciale, BDI e akuzon: Barazon viktimën me agresorin

13/09 17:56



Zgjidhet Qeveria e re e Kosovës, Kurti rikthehet në krye të ekzekutivit me 62 vota pro

13/09 15:38



Albulena Haxhiu mandaton Albin Kurtin Kryeministër të Kosovës: Sukses në ushtrimin e përgjegjësive që burojnë nga besimi i qytetarëve

13/09 13:19



Konstituohet Kuvendi i Kosovës/ Zgjidhen nënkryetarët, PDK mbetet pa përfaqësues

13/09 10:59




Pas bojkotimit të seancës së konstituimit, PDK tërheq përkohësisht kandidaturën e Vlora Çitakut për nënkryetare të Kuvendit

13/09 10:48

## Kryesore »



Aksident tragjik në Peqin/ Makina përplas të moshuarin me biçikletë, ndërron jetë 70-vjeçari

14/09 11:58



"Sa të sigurt janë fëmijët tanë?"/ Diskutime për "Smart City" në Komisionin "Xhafaj", kreu i AKSK: Siguria është maksimale, por...

14/09 11:53



Analizë nga Filip Çakuli: Drejtësia kërkon drejtësi... për rrogën e vet!

14/09 11:35



Bllokuan akset kryesore të Tiranës gjatë tubimit të djeshëm, procedohen penalisht 20 protestues

14/09 11:32



Takim në kryesinë e Kuvendit, Niko Peleshi pret të ngarkuarën me punë të SHBA-së Nancy VanHorn

14/09 11:25



Premier League pranon gabimin: Goli i Haaland ndaj Manchester United nuk duhej të ishte quajtur i rregullt

14/09 11:22

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Korça nis vitin shkollor me më pak nxënës, mbi 18 mijë ulen në banka



Top News – Nafta mbi 108 dollarë për fuçi. Tensionet në Hormuz rrisin frikën për furnizimet globale



Top News – Konstituimi në Kushtetuese, Kurti mbledh qeverinë








‘Ndizet’ lufta Greqi – Turqi/ Kërcënimi turk: Do pushtojmë ishujt/ Ekspertët ‘zbërthejnë’ skenarin

Top Channel/ Viti i ri shkollor në Shkodër, më pak nxënës në klasat e para, mbi 15 mijë në qark

Top Channel/Sulmi rus pranë kufirit polak, shpëtuan “për fije” ish shefi i CIA-s dhe Boris Johnson!




**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.